



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 02 tetor 2012, në orën 10:00, salla N-10
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Munguan: Murselj Haljilji dhe Afrim Hoti.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON- auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12. 09. 2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2011– Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
4. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12.09.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 12.09.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2011 – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Kryetari – Komisioni, lidhur me shqyrtimin e këtij raporti, përveç mbledhjes së sotme, ka mbajtur edhe punëtori dyditorë dhe një dëgjim publik, ku ka shqyrtuar pjesën që ka të bëjë me auditimin e komunave. Komisioni do t'i drejtohet Kuvendit me rekomandime konkrete. Komisioni ka konstatuar se në pushtetin qendror, problematikat kryesore kanë të bëjnë me: fushën e prokurimit, fushën e auditimit të brendshëm, dhe çështjen e borxheve të bartura në vitin 2009 - 4 milionë, në vitin 2012 – 28, ndërsa në vitin 2011 - 40 milionë. Kjo dukuri është dashur të mos ekzistojë fare, apo të jetë në rënie, ndërsa lidhur me këtë Qeveria duhet të ndërmarrë masa konkrete. Lidhur me këto çështje, Komisioni duhet të dalë me rekomandime konkrete. Kjo është karakteristikë e të gjitha mistrive. Duhet diskutuar edhe çështja e borxheve të këqija. Ishte i mendimit që Komisioni të kërkojë nga Qeveria të trajtojë këtë temë: Pse ka ardhur deri te kjo gjendje? Cilat janë rrethanat që borxhi për 6 vite nuk është kërkuar? Po ashtu propozoi që përveç rekomandimeve për nivelin qendror, të dalë edhe me rekomandime për nivelin lokal. Sa i përket rekomandimit të ZAP-it për një pozite të re (menaxher i ekzekutivit) në nivelin lokal, ishte i mendimit që duhet të ndryshohet Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Ligji për menaxhimin e financave publike. Hapi diskutimin.

Ramiz Lladrovci – U pajtua me propozimet e kryetarit, por sipas tij, rekomandimet duhet të bëhen të sakta, ndërsa shpjegimet për rekomandime duhet të bëhen në mbledhje plenare.

Z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Raporti fillimisht flet për raportet financiare nga Qeveria dhe rekomandimi ishte se në shumicën e aspekteve janë të sakta. Por, duhet të shikohen edhe dobësitë në raportet financiare të Qeverisë, në mënyrë që informacioni të jetë më transparent. Rekomandimet janë shumë të rëndësishme për pronarët. Dhe nëse gjendja përshkruhet siç e prezantoi kryetari, atëherë këto nuk do të përfshiheshin. Borxhet tatimore janë mjete që nuk do të merren kurrë dhe ato borxhe vetëm po e rrisin qarkullim. Aty janë të përfshira edhe borxhet e këqija nga ndërmarrjet publike, pastaj borxhi nga KEK-u. Lidhur me këtë, edhe MF ka kërkuar ndihmë. Kemi të bëjmë me pasuritë që kemi dhe me mënyrën se si po përdoren. Qeveria nuk po i rregullon pasqyrat financiare të organizatave buxhetore me kohë. Komisioni duhet të kërkojë raport më të mirë, më të detajuar, ku pasqyrohet gjendja e vërtetë në shtet.

Ramiz Lladrovci – Propozoi që rekomandimi i parë të jetë: Të miratohet Raporti vjetor i auditimit me rekomandime, përgatitur nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me raport me shkrim ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ndërsa, lidhur me pjesën që ka të bëjë me pushtetin lokal, kërkoi mendimin e auditorit se kush është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve, në mënyrë që Komisioni të dalë me rekomandim konkret lidhur me këtë pjesë të raportit, sepse mund të ketë bërë me shumë ministri.

Armend Zemaj – Përkrah Raportin vjetor të auditimit dhe gjuha e rekomandimeve është shumë më e qartë. Raporti ka një përshkrim të qartë të të gjeturave dhe të rekomandimeve. Rekomandimet e tilla mund të implementohen në vitin paraparak apo për një kohë të shkurtër. Qeveria duhet të afatizojë se deri kur mund t'ia dorëzojë raportin Kuvendit, rreth zbatueshmërisë së rekomandimeve të ZAP-it. Po ashtu, nëse Komisioni vendos të shkojë me rekomandime specifike, atëherë duhet pasur kujdes se cilave çështje iu jep përparësi. Për të mos anashkaluar asnjë të gjetur, ishte i mendimit që Komisioni të dalë në mbledhje plenare me rekomandime të përgjithshme.

Ramiz Lladrovci – Nëse ngritët problemi i borxheve, atëherë duhet kërkuar nga ATK-ja që ta njoftojë Kuvendin për trajtimin e borxheve dhe listën e tyre. Me rekomandime të përgjithshme

arrihet qëllimi, meqenëse edhe auditori ka rekomanduar trajtimin e këtyre borxheve.

Z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Ishte i mendimit që Komisioni t'i propozojë Kuvendit, që raporti i Qeverisë për Kuvendin, të jetë më i mirë, që kualiteti i informacionit të jetë në pajtim me rekomandimet e auditorit të përgjithshëm. Pra, kërkesa e Kuvendit duhet të jetë që Qeveria të bëjë informacion më të mirë për Kuvendin dhe për qytetarët e Kosovës.

Sa i përket përgjegjësisë për zbatim të rekomandimeve në nivelin lokal, rekomandimet e përgjithshme, sa i përket menaxhimit financiar, të gjitha janë për Qeverinë.

Adem Grabovci – Ishte i pajtimit që në vazhdimësi të kërkohet nga institucionet që të ngrihet niveli i raportimit dhe ndau mendimin me deputetin Lladrovci dhe Zemaj, për rekomandimet në mbledhje plenare.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri vendosi që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i auditimit, me rekomandime, përgatitur nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.**
- 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, më së largu deri më 31 mars 2013, me raport me shkrim ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.**
- 3. Në mbledhje plenare të ftohet Auditori i përgjithshëm, për të prezantuar Raportin vjetor të auditimit për vitin 2011.**
- 4. Arsyetimin e Rekomandimit do ta paraqesë, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

4. Të ndryshme

a). Diskutim rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Po ashtu, ai ngrii shqetësimin që Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF), nuk ka koordinuar punën e grupit të punës me anëtarët e KMFP-së për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sipas tij, në radhë të parë do të duhej që të mblidhej grupi i punës për të hartuar platformën e punës pastaj për të mbajtur takime dhe vizita. Po ashtu, në ftesën e fundit që ka pas nga KBF, ishte përgatitur lista e pyetjeve për ministrin, pa i informuar anëtarët e grupit të punës.

Ramiz Lladrovci- U pajtua që agenda nuk është dakorduar, por me kohë është njoftuar për mbledhje dhe për listën e pyetjeve të përgatitura për vizitat në Ministri. Personalisht ka dërguar pyetje shtesë për grupin e punës.

b) Diskutim rreth organizimit të takimeve të Komisionit me mediat dhe shoqërinë civile

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se me përkrahjen e KIPRED-it, është planifikuar të organizohet një takim joformal me përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile, për të

diskutuar rreth mënyrës së punës së Komisionit, qasjen në punën e Komisionit. Po ashtu, me përkrahjen e KIPRED – it është planifikuar një punëtori (trajnim). Për detaje të tjera do të njoftoheni me kohë.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Takimi me përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile do të mbahet më 09 tetor 2012.**
- 2. Punëtorja organizohet më 22 dhe 23 tetor 2012.**
- 3. Shpenzimet për këto dy aktivitete të Komisionit, mbulohen nga KIPRED-i.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu